



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina



## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së parë të Komitetit për Politikës dhe Financa, e mbajtur më  
23.02.2018, duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Komitetit, anëtarët e Komitetit: Visare Gashi, Genc Sherifi, Milot Podvorica, Vala Peshku, Halim Halimi, Agim Gashi, Jeta Rafuna, Blerand Stavileci, Fadil Gashi dhe Sami Boroci.

Në mbledhje morën pjesë edhe: Selim Pacolli, nënkryetar i Komunës së Prishtinës, Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Yll Rugova, drejtor i Drejtorisë së Kulturës, Fatos Dibra, përfaqësues i Zyrës ligjore, Mentor Leka, zyrtar nga OSBE-ja, dhe Admir Shala.

Para se të fillonin me pikat e rendit të ditës, kryesuesi i informoi të pranishmit lidhur me vendimin i cili është kthyer nga MAPL-ja, që ka të bëjë me mos përfaqësimin e barazisë gjinore, d.m.th. përfaqësimit të femrave, ku thuhet se duhet të jetë përfaqësimi gjinor 50:50.

Ai tha se nuk ka asnjë institucion që bazohet në ligj dhe nuk është i obliguar me e pasur përfaqësimin e barazisë gjinore 50:50, por kjo është vetëm synim.

Sa i përket respektimit të barazisë gjinore, është trajtuar lista e anëtarëve të KPF-së, ku thotë se VV-ja është e përfaqësuar 50:50, LDK-ja realisht reflekton me përqindje përfaqësuese në Kuvend dhe janë 2:1, por problemi është se nga subjektet politike PDK, AAK dhe AKR, të gjithë anëtarët i përkasin gjinisë mashkullore.

Bazuar në këtë, ai shtroi pyetjen se a mund të bëhet ndonjë ndryshim dhe të plotësohet ky kriter.

Halim Halimi lidhur me respektimin e përfaqësimit të barazisë gjinore, tha se duke u nisur që nga Ligji për barazi gjinore, shihet se është bërë shkelje, mirëpo meqë Ligji për zgjedhje e ka paraparë 30% të jenë të përfaqësuar gjinia femërore, tani meqë është formuar Komiteti për Politikë dhe Financa dhe trupat e tjerë ndihmës të Kuvendit, tani kërkohet që përfaqësimi të jetë 50:50, që vërtet është pak problem.

Ai propozoi që të jetë një konstatim nga ky takim, se nuk është respektuar Ligji mbi barazinë gjinore dhe është bërë shkelje, kurse në mbledhjen e Kuvendit do të shikojmë se çka mund të bëjmë në këtë drejtim.

Ai u shpreh se është i thhtar i zbatimit të Ligjit dhe zbatimit të rekomandimeve që vijnë nga MAPL-ja.

**Fatos Dibra** tha se në përbërjen e Kuvendit komunal respektimi i barazisë gjinore reflekton 70:30, kurse në Rregulloren për komitetet e përhershme reflekton përbërja e Kuvendit komunal.

**Kryesuesi**, sa i përket Komisionit të aksionarëve, tha se përfaqësimi i barazisë gjinore në total është 36%, nëse e shohim si ndërmarrje komplet, por kërkesa e tyre ka qenë të shkohet në 50:50.

**Osman Bllaca** theksoi se nëse mendohet të bëhen ndryshime, atëherë duhet të futet prapë në rend të ditës formimi i KPF-së.

Pas diskutimeve dhe sugjerimeve që u cekën, u pajtuan që në mbledhjen e radhës, nëse do të ketë ndonjë ndryshim, të futet si pikë e rendit të ditës.

**Z. Bllaca** bëri të ditur se është edhe kërkesa nga Njësia e barazisë gjinore, e që është Plani i veprimt për personat me aftësi të kufizuara në komunën e Prishtinës 2018 – 2020, dhe propozoi që të futet në rend të ditës, sepse kësaj kategorie mund t'i humbin donacionet nga DEMOS-i, por edhe kishin një afat kohor, që deri më 15 mars të miratohet Plani i veprimt Kuvendi i Komunës.

**Agim Gashi** u shpreh se me shtimin e këtyre dy pikave në rend të ditës do të bëhen 16 pika, andaj propozoj që këto të ndahen në dy pjesë, sipas prioriteteve, pasi që nuk më duket normale të trajtohen 16 pika në një seancë, ku pritet të trajtohen tri rregullore, dy propozime për plane rregulluese dhe raportin financiar.

**Kryesuesi propozoi këtë**

#### REND DITE:

1. Propozimvendimi për hartimin e Planit zhvillimor komunal "Prishtina 2018 - 2026";
2. Propozimvendimi për hartimin e Hartës zonale të komunës së Prishtinës 2018 - 2026;
3. Raporti financiar buxhetor (TM 4) janar - dhjetor 2017;
4. Përmirësimi i gabimit teknik në pjesën tekstuale të PRRH "Kodra e Trimave 1";
5. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronares Lumnije (Musa) Latifi;
6. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Luan (Ramadan) Hoxha dhe Armend (Ramadan) Hoxha;
7. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Enver (Ali) Aliu dhe Xhemajl (Hasan) Krasniqi;

8. Propozimvendimi për miratimin paraprak të dhënies së pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS);
9. Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Rregulloren për ndarjen e subvencioneve në komunën e Prishtinës;
10. Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Rregulloren për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së veprimtarive afariste në komunën e Prishtinës;
11. Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Rregulloren për caktimin e tarifës për leje mjedisore komunale;
12. Propozimvendimi për formimin e Komitetit për Komunitete;
13. Propozimvendimi për formimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit për vitin 2018;
14. Të ndryshme.

**Pika e parë**

Propozimvendimi për hartimin e Planit zhvillimor komunal "Prishtina 2018 - 2026".

**Genc Bashota** tha se pika e parë dhe e pika e dytë janë të ndërlidhura me njëra tjetrën, sepse hartimi i Hartës zonale sipas ligjit, ka parakusht rishikimin apo hartimin e planit zhvillimor komunal, pra, siç e dini, Harta zonale është dokument më i lartë i planifikimit hapësinor.

Lidhur me Planin zhvillimor komunal, të miratuar në vitin 2018, me afat deri në vitin 2022, e keni sa për informim, pasi që Harta zonale duhet të hartohet për tetë vitet e ardhshme, siç parashihet me Udhëzim administrativ të Ministrisë, që të rishikohet dhe të hartohet edhe një herë paraprakisht Plani zhvillimor komunal.

Ai propozoi që të formohet një komitet drejtues, ku do të përfshihej një numër i madh ekspertësh të fushave të ndryshme, të cilët nuk janë punonjës të Komunës, por ekspertë të fushave në tërë Kosovën. Njëherësh të formohet grupi punues, ku do të ishin të përfshirë ekspertë, duke u nisur nga Drejtoria e Planifikimit dhe të gjitha drejtoritë e tjera të Komunës.

**Agim Gashi** lidhur me formimin e grupit punues dhe komitetit drejtues, tha se Ligji për planifikim hapësinor ia lë në kompetencë Kryetarit të Komunës që të formojë atë lloj komisioni, por nuk e di se a mund të kemi në rol në atë punë.

Sa i përket formulimit të pikës së rendit të ditës, ai shprehu mendimin se ndoshta do të ishte më mirë që formulimi i saj të jetë: "Propozimvendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Planit zhvillimor komunal 2018 - 2026". Do të ishte mirë që të jemi kompatibil me natyrën e rendit të ditës dhe përmbajtjes.

**Fatos Dibra** tha se meqë çështjet teknike të Planit zhvillimor komunal nuk i di, por janë zyrtarët e planifikimit hapësinor që e dinë më mirë, por nëse do të ketë plotësim-ndryshime të mëdha në atë plan, atëherë më mirë është që të bëhet komplet ndryshimi dhe plotësimi i tij.

**Agim Gashi** lidhur me plotësimin dhe ndryshimin e Planit zhvillimor komunal, tha se nëse do të bëhen plotësime dhe ndryshime në atë dokument, atëherë ai duhet të kalojë përmes Kuvendit, ku Kuvendi merr vendim, sepse nuk ka instancë nën Kuvendin që mund ta ndryshoj atë.

**Blerand Stavileci** lidhur me përpilimin e pikës së rendit të ditës, shprehu mendimin se zgjidhja më e thjeshtë, më e drejtë, më e arsyeshme dhe më e logjikshme është ajo që bëhet në secilin plan, kur thuhet: Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit zhvillimor komunal, dhe i cek vitet, si p.sh. 2018-2026.

**Halim Halimi** shtroi pyetje, duke thënë se po që se ne e shfuqizojmë Planin zhvillimor komunal ekzistues deri në miratimin e Planit të ri zhvillimor komunal, atëherë mbi çfarë baze do të punojmë ne.

**Visare Gashi** shprehu mendimin se nëse merremi me hartimin e Planit zhvillimor komunal 2018 - 2026, atëherë do të duhej të kishim një vendim të shkurtër, si justifikim se deri në çfarë mase ka devijuar plani i mëparshëm zhvillimor. Drejtoritë nuk e kanë të vështirë ta evidentojnë se deri në çfarë mase është bërë devijimi dhe të na japin një arsyetim.

**Vala Peshku** tha se kjo është e shpjeguar shumë mirë në bazë të Udhëzimit administrativ, që do të thotë se ka përcaktuar përmbajtjen shtesë dhe nuk është bërë devijim, por është plotësim i kërkesës së Udhëzimit administrativ.

**Kryesuesi** theksoi se është rregull që parasheh se nëse bëhet fjalë për ndryshim deri në 40%, konsiderohet se po bëhet plani i ri, prandaj edhe e kanë problem tani me e ditur secili, siç tha edhe z. Agim Gashi, se sa është përqindja e saktë.

**Fatos Dibra** u shpreh se, meqë Plani zhvillimor komunal aktual e ka afatin deri në vitin 2022, qëllimi i ndryshimit është që të bëhet me hartë zonale, në mënyrë që ta ketë afatin e njëjtë.

Edhe nga Ministria është thënë se ju PZHK-në duhet ta keni për tetë vjet, ashtu sikurse edhe Hartën zonale, për arsye se HZK-ja duhet t'i përmbahet PZHK-së.

**Blerand Stavileci** lidhur me pikën e parë, e cila lidhet plotësisht me të dytën, tha se do të ishte mirë të bëhet një përshkrim i Planit zhvillimor komunal, së paku për një periudhë tetë vjeçare. Ndër të tjera, ai tha se ideja është të parashtrahet si pikë e rendit të ditës, duke i pasur brenda motivet dhe detyrat e komitetit drejtues se çka ka me u bërë, si dhe cilat janë detyrat e grupit punues, në mënyrë që ne ta kemi një pasqyrë dhe të ecim tutje e mos të ndalemi këtu.

**Kryesuesi** konstatoi se më tetë vota për, dy kundër, u miratua Propozimvendimi për hartimin e Planit zhvillimor komunal "Prishtina 2018 - 2026" dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

## **Pika e dytë**

### **Propozimvendimi për hartimin e Hartës zonale të komunës së Prishtinës 2018 – 2026.**

**Genc Bashota** theksoi se, meqë pika e dytë ndërlidhet me të parën, tema kryesore e Drejtorisë së Planifikimit gjatë katër viteve të ardhshme, do të jetë hartimi i Hartës zonale, për arsye se ne e kemi Planin zhvillimor komunal, Planin zhvillimor urban dhe planet rregulluese të hollësishme, ku ka diskrepanca të mëdha, ka mospërputhje dhe telashe të mëdha.

Ne shumë herë jemi munduar të bëjmë plane rregulluese, të cilat Ministria na i ka kthyer si të kundërligjshme, d.m.th. se jemi në një situatë të palakmueshme në këtë drejtim.

Ai u shpreh se Drejtoria e Planifikimit i ka bërë incizimet gjeodezike së bashku me DEMOS dhe me një organizatë tjetër, e cila i ka financuar diku 30 praktikantë, ku është punuar mjaft gjatë, që d.m.th. se e kemi data-bazën më të mirë në Kosovë. E kemi bërë edhe identifikimin e infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore të KEDS-it, PTK-së, ndërmarrjes “Termokos”, ujësjellësit “Prishtina” etj. Sa i përket normave të planifikimit hapësinor, Ministria nuk i ka përcaktuar ato deri në gusht të vitit të kaluar, kur e ka sjellë Udhëzimin administrativ dhe ato të njëjtat i ka nxjerrë në shkurt të këtij viti, ndërsa sa i përket PZHK-së dhe HZK-së, kemi menduar që ato të procedohen së bashku.

**Halim Halimi** theksoi se sipas Ligjit për planifikimin hapësinor parashihet të nxirren tri dokumente, të cilat u përmenden më herët, d.m.th. Plani zhvillimor komunal, Harta zonale dhe planet rregulluese të hollësishme. Sa i përket Hartës zonale, neve që kemi punuar më herët këtu vazhdimisht na është thënë se jemi duke punuar dhe jemi afër përfundimit të Hartës zonale, që d.m.th. ne kemi nxjerrë vendime dhe kemi miratuar plane rregulluese pa hartë zonale. Nuk është ajo se Ministria na i ka kthyer si të kundërligjshme, por është ligji ai që na i ka kthyer si të kundërligjshme, d.m.th. Ministria ka punuar sipas ligjit.

Ai shprehu mendimin se Harta zonale është e domosdoshme dhe propozoi që ajo të kryhet sa më shpejt, pasi që tashmë jemi vonuar.

**Sami Boroci** u shpreh se përgjigjen e mora nga diskutimi i drejtorit me z. Halimi, por më intereson se deri ku ka shkuar procesi, dhe shpresoj se do të kryhet brenda aftit të planifikuar.

**Agim Gashi**, sa për opinion, tha se raportet nuk janë zhvilluar në mënyrë korrekte për katër vjet, sepse asnjëherë nuk është prezantuar gjendja reale se në çfarë intensiteti dhe në çfarë shkalle Komuna ka punuar në këtë drejtim, por e ka përmbyllur me një fjali, duke thënë se deri në qershor të vitit 2014, 2015, 2016 do të jetë në rregull se jemi në përfundim, ku dhe është zhvilluar luftë në mes grupeve për këtë çështje.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Propozimvendimi për hartimin e Hartës zonale të komunës së Prishtinës 2018 - 2026 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

**Pika e tretë**

**Raporti financiar buxhetor (TM 4) janar - dhjetor 2017.**

**Osman Billaca** lidhur me raportit financiar buxhetor, tha se ky raport është bërë nga drejtori i mëparshëm, z. Ismail Kokaj, por kjo është edhe një përgjegjësi e Kryetarit të Komunës.

TM 4 e kemi shkruar sepse jemi të obliguar ligjërisht të raportojmë çdo tre muaj gjendjen financiare. Vërejtjet dhe sugjerimet do t'i marrim, pastaj në mbledhjen e Kuvendit drejtori do t'i prezantojë më detajisht.

**Vala Peshku** tha se vërejtja e vetme ka qenë kjo, pasi që e cekët se është (TM 4), kurse në fakt e ka përfshirë komplet vitin 2017. Nuk e di kush e përgatit raportin, por do të ishte mirë që të tregohet kujdes, pasi që tabelat dhe zonat buxhetore janë të tejzgjatura dhe përsëriten në secilën faqe.

**Agim Gashi** lidhur me raportin financiar buxhetor, tha se Grupi parlamentar i LDK-së fjalën e vet do ta thotë në mbledhjen e Kuvendit.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua raporti financiar buxhetor (TM 4) janar - dhjetor 2017 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

**Pika e katërt**

**Përmirësimi i gabimit teknik në pjesën tekstuale të PRRH "Kodra e Trimave 1"**

**Genc Bashota** lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, tha se kur e kemi miratuar, vitin e kaluar, Planin rregullues të hollësishëm "Kodra e Trimave 1", e kemi dërguar në Ministri, ku konfirmimi ligjor nga Ministria është vonuar jashtë afatit ligjor. Pastaj ne e kemi shpallur Planin rregullues të hollësishëm në fuqi, mirëpo jashtë këtij konteksti që e diskutuam më herët, zyrtarët tanë kanë vërejtur se është bërë gabim tek pjesa teknike, e cila nuk përputhet me tabelat, ndërsa nga ana e kompanisë thuhet se pjesa tekstuale është në rregull.

**Halim Halimi** lidhur me Planin rregullues të hollësishëm "Kodra e Trimave 1", tha se ne vetëm e kemi parë Hartën zonale, ku dhe të gjithë u bindëm se pa Hartën zonale nuk mund të bëhen planet rregulluese të hollësishme.

Ai u shpreh se Kuvendi i Komunës e ka marrë një vendim me shumicë votash, me përjashtim të disave, ku unë si kryesues kam qenë kundër, e që prapë do të jem kundër këtu në KPF dhe në mbledhje të Kuvendit.

Kryesuesi konstatoi se më tetë vota për, tri kundër, u miratua Propozimvendimi për përmirësimin e gabimit teknik në pjesën tekstuale të PRRH "Kodra e Trimave 1" dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

## **Pika e pestë**

**Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e pa luajtshme në pronësi të pronares Lumnije (Musa) Latifi.**

**Fatos Dibra** lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, tha se këto janë zakonisht palët të cilat kërkojnë leje ndërtimore, kërkojnë nga Drejtorinë e Urbanizmit që t'u jepet një pëlqim paraprak për Drejtorinë e Pronës.

**Dren Kukaj** lidhur me pikat 5, 6, 7, të cilat kanë të bëjnë me këmbimin e pronave, është krijuar një praktikë, të cilën ne në Drejtorinë e Urbanizmit e kemi trashëguar, gjë të cilën e kemi përcjellë edhe në mandatin e kaluar.

**Agim Gashi** theksoi se për ta pasur ne më lehtë në procedura dhe për të mos u kthyer ato mbrapa, detyrë e ekzekutivit është që të na japë sqarime neve këshilltarëve, pasi që për ne gjuha e kadastrit dhe e urbanizmit është e pakuptueshme. Andaj propozoi që prezantimi të na qartësohet më mirë, në mënyrë që të kuptohet më mirë dhe të kuptohet më lehtë se kush janë pronarët, adresa e saktë, çka merret e çka jepet e kështu me radhë.

**Fadil Gashi** shtroi pyetje për drejtorin, se a ka edhe kërkesa të tjera përveç këtyre dhe nëse ka edhe të tjera, atëherë pse janë caktuar vetëm këto tri rate.

**Dren Kukaj** lidhur me pyetjen që u shtrua nga z. Fadil Gashi, tha se këto i sjell Drejtoria e Urbanizmit, kurse ne vetëm e formalizojmë si të tillë. Këtu nuk janë të gjitha rastet e pronave private që kanë në afërsi prona publike, ku rastet e tilla ne i sjellim në drejtorinë tonë dhe i trajtojmë e pastaj dërgohen për Kuvend.

Ai në vazhdimësi tha se ky këmbim, apo dokumentacion që e kemi shkon në Drejtorinë e Urbanizmit, pastaj vjen në Kuvend për votim, e më pas dërgohet në MAPL, në Ministrinë e Financave për vlerësim, kthehet në Drejtorinë të Pronës, te kryetari, pastaj në Kadastër dhe në fund shkon në Drejtorinë e Urbanizmit, nga ku pronarët pajisen me leje ndërtimore.

**Blerand Stavileci** duke iu referuar asaj çka u tha më herët nga drejtori, se kemi vazhduar me praktikën e kaluara, ku njëherësh u përmend edhe rregullorja, e cila është në përfundim e sipër, propozoi që të pritet të dalë ajo Rregullore, sepse ajo do të jetë çelës për t'u përcjellë të gjitha këto që u përmenden.

**Kryesuesi** kërkoi nga Drejtoria e Pronës që materiali për Kuvend të jetë më i detajizuar.

**Agim Gashi**, propozoi që pikat 5,6 dhe 7 të votohen në paketë.

**Kryesuesi** konstatoi se me nëntë vota për, një votë kundër dhe një abstenim u miratuan këto propozimvendime: Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronares Lumnije (Musa) Latifi; Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale

me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Luan (Ramadan) Hoxha dhe Armend (Ramadan) Hoxha, si dhe Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Enver (Ali) Aliu dhe Xhemajl (Hasan) Krasniqi dhe dërgohen në Kuvend për miratim.

#### **Pika e tetë**

**Propozimvendimi për miratimin paraprak të dhënies së pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim Kompanisë për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS).**

Dren Kukaj lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, tha se kjo është në kuadër të obligimeve ligjore që kanë të bëjnë me interesat e qytetarëve, që KEDS-i ta vendosë një trafo për përforsimin e energjisë elektrike, ku dhe jemi të obliguar që me automatizëm ta shpejtojmë shqyrtimin e kërkesës kudo që ata e vlerësojnë se është e domosdoshme dhe e rëndësishme me u distribuuar energjia elektrike.

Agim Gashi tha se Ligji mbi dhënien e pronës në shfrytëzim e obligon Komunën me e ndarë parcelën, ku Komuna e ka një rol tjetër, me e parë dhe me e njohur rrjetin e distribuimit të energjisë elektrike në territorin e saj. Ne kemi shumë pjesë në komunën tonë ku rryma është e dobët, instalimi është i vjetruar, si dhe furnizimi i energjisë elektrike bëhet në mënyrën më të keqe të mundshme. Pra, Komuna në këtë aspekt mund ta luajë një rol shumë të rëndësishëm, me i diktuar pak a shumë orientimet e investimeve të tyre, me qëllim që të përmirësohet furnizimi cilësor i rrjetit elektrik.

Blerand Stavileci tha se KEDS-i e ka një plan për zgjerimin e rrjetit, shkojnë në baza rajonale dhe i kanë afatet kohore. Ata ndoshta e sjellin planin e tyre tek ne, por duhet pasur kujdes të miratimi i atij plani, se ata ndoshta aty mund t'i kenë të përfshira 13 pika, kurse ne ndoshta mund t'i kishim edhe katër të tjera, që do të bënin 17 pika. Prandaj, kishte me qenë mirë të kemi një gjendje, apo një skenim të terrenit, në mënyrë që të jemi më të njoftuar lidhur me punën e tyre.

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Propozimvendimi për miratimin paraprak të dhënies së pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim Kompanisë për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS) dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

#### **Pika e nëntë**

**Propozim vendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Rregulloren për ndarjen e subvencioneve në komunën e Prishtinës.**

Fatos Dibra tha se kjo më parë ka qenë e rregulluar me një vendim të Kryetarit, mirëpo në ndërkohë nga Ministria është miratuar një rregullore që i përcakton këto subvencione. Ka qenë shumë e nevojshme për t'u bërë një projektregullore në Kuvendin e Komunës, që do t'i përcaktonte të gjitha rregullat e ndarjes së

subvencioneve, që është punuar nga një komision, në përbërje të pesë anëtarëve, të cilët e kanë bërë projektin e parë.

Ky projekt tani shkon në diskutim publik, ku edhe në diskutim publik, por edhe pas shqyrtimeve në Kuvendin e Komunës, munden të jepen propozimet që të shtohet ose të hiqet diçka.

**Halim Halimi** theksoi se kjo është një rregullore të cilën e ka punuar "Helvetas", në punimin e së cilës kanë marr pjesë edhe anëtarë të Kuvendit të Komunës dhe të ekzekutivit, në mesin e tyre kemi qenë unë dhe z. Osman Bllaca. Për këtë rregullore nuk kam vërejtje, mirëpo aty nuk kanë qenë të përfshira bursat për shkolla fillore, kurse tani po e shoh se edhe ato janë të përfshira në këtë rregullore.

**Blerand Stavileci** theksoi se është të kemi rregullore të tilla, për shkak se në nivel qendror, por edhe në nivel lokal e kemi një kategori buxhetore "subvencionet dhe transferet", nga e cila ndahet një sasi e konsiderueshme e mjeteve.

Ai u shpreh se, duke e pasur përvojën nga punimi i Planit për bujqësi dhe zhvillim rural në tërë Kosovën, kur është dashur me subvencionuar edhe në nivel lokal, p.sh. në fushën e bujqësisë, ta zëmë se një fermer i cili po merret me kultivimin e grurit, apo dikush e ndërton një serrë e është në komunën e Prishtinës, ai mund të përfitoj nga niveli qendror dhe nga niveli lokal. Pra, do të thotë se nëse ai është në rregull me të gjitha, siç punohet në nivelin qendror, atij vetëm se i shtohet sasia e mjeteve nga niveli lokal.

Në Rregullore ishin të përfshira të gjitha drejtoritë, do të ishte mirë që nga çdo drejtori të dalë përfaqësuesi kompetent dhe të na njoftojë se për çka janë shfrytëzuar ato subvencione.

**Agim Gashi** lidhur me Rregulloren, theksoi se kur do të ballafaqohemi në terren me kërkesat e qytetarëve, do të kemi problem me u zbatuar në harmoni kërkesat e qytetarëve, posaçërisht në fushën e bujqësisë, për arsye se e dini shumë mirë se statusi i tokës tek ne është në gjendje shumë të keqe. Arsyeja e kësaj që e thash është se njerëzit nuk i kanë të rregulluara pronat, e deri tash subvencionet janë ndarë bazuar në pronarët e tokës.

Ai shprehu mendimin se duhet pasur kujdes me ndarjen e subvencioneve, sepse ka pasur shumë keqpërdorime në këtë aspekt, për shkak se ka pasur raste kur pronari i tokës ka marrë subvencione, kurse prodhuesi nuk ka mundur të marrë.

**Milot Podvorica** tha se meqë ka dyshime që mund të keqpërdoren subvencionet, do të ishte mirë që kësaj rregulloreje t'i shtohet edhe pjesa e sanksioneve, të shqiptimit të gjobave për keqpërdorim.

**Osman Bllaca** lidhur me subvencionet, tha se është problem i madh, sepse me z. Halimi kemi përfaqësuar Komunën e Prishtinës kur është bërë një rregullore e tillë për të gjitha komunat. Sa i përket subvencioneve, kemi pasur kategorinë e Kryetarit që i ka ndarë subvencionet, p.sh. Drejtoria e Bujqësisë, Drejtoria e Kulturës, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Arsimit, ku për secilën na është dashur të nxjerrim pajtim me caktuar kritere të veçanta dhe për atë arsye e kemi bërë këtë.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Rregulloren për ndarjen e subvencioneve në komunën e Prishtinës dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

**Pika e dhjetë**

Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Rregulloren për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së veprimtarive afariste në komunën e Prishtinës.

Genc Bashota bëri të ditur se këtë propozimvendim e ka bërë Zyra ligjore, bashkë me Kryetarin, edhe pse po e shoh që edhe drejtoria ime është e përfshirë këtu dhe kjo shkon për diskutim publik.

Ai njëherësh tha se ky është një propozim për rregullimin e orarit të punës së veprimtarive afariste dhe të tjera, ku ideja është rregullimi i orarit të punës së veprimtarive afariste, sepse po kemi ankesa nga qytetarët, të cilët kërkojnë qetësi, përderisa bizneset kërkojnë të punojnë në atë kohë.

Agim Gashi lidhur me këtë Rregullore tha se, meqë vet titulli thotë "Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës së veprimtarive afariste dhe veprimeve të tjera", duhet të përmirësohet, duke i përfshirë edhe shkollat private dhe çerdhet, sepse del në mospërputhshmëri me përmbajtjen e rregullores.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Rregulloren për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së veprimtarive afariste dhe veprimtarive tjera në komunën e Prishtinës dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

**Pika e njëmbëdhjetë**

Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Rregulloren për caktimin e vlerës referente investuese të projektit të ndërtesave për caktimin e tarifës për leje mjedisore komunale.

Genc Bashota theksoi se edhe kjo rregullore do të shkojë në diskutim publik, mirëpo në pika të shkurtra i informoi të pranishmit se kur pala e merr lejen ndërtimore, ajo pastaj bën kërkesën për leje mjedisore. Tek objektet e mëdha ka diskrepancë të madhe në cilësinë e ndërtimit. Ka raste kur vinë palët dhe bien paralogari dhe paramasa të ndryshme, ku thonë se mua më kushton 150 euro metri katror e në bazë të asaj i paguan 0.2%.

Agim Gashi u shpreh i pajtimit më konstatimin se ka dallime në cilësinë e ndërtimit, sepse ka objekte që ndërtohen në 200 metra katrorë e paguajnë 400 euro për metër katror.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Rregulloren për caktimin e vlerës referente investuese të

projektit të ndërtesave për caktimin e tarifës për leje mjedisore komunale dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

**Pika e dymbëdhjetë**

**Propozimvendimi për formimin e Komitetit për Komunitete.**

Kryesuesi tha se ky komitet duhet të përfaqësohet si nga komuniteti shumicë, ashtu edhe nga komunitetet pakicë.

**Osman Bllaca** tha se nga komunitetet pakicë anëtarë të Komitet do të jenë:

1. Kimete Shok, komuniteti goran;
2. Oktay Kurtës, komuniteti turk;
3. Nenad Miladinović, komuniteti serb;
4. Adnan Ajeti, komuniteti rom;
5. Idriz Berisha, komuniteti ashkali;
6. Mirsada Behluli, komuniteti boshnjak.

Ai bëri të ditur se në këtë Komitet duhet të përfshihen edhe tre anëtarë nga komuniteti shumicë, dy prej të cilëve duhet të jenë anëtarë të Kuvendit të Komunës, kurse një jashtë Kuvendit. Anëtari i tretë i këtij komiteti, i cili nuk është anëtarë i Kuvendit, do të jetë z. Hetem Kupina, që mori më së shumti vota.

**Halim Halimi** tha se GP i LDK-së për anëtarë të Komitetit për Komunitete propozon znj. Elmira Nikçi.

Kryesuesi tha se propozimet mund të bëhen edhe në mbledhjen e Kuvendit.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua **Propozimvendimi për formimin e Komitetit për Komunitete dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

**Pika e trembëdhjetë**

**Propozimvendimi për formimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit për vitin 2018.**

Kryesuesi lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, tha se kjo proceduralisht propozohet në Kuvend, ku secila nga partitë e ka nga një përfaqësues dhe një nga sekretaria e Kuvendit.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua **Propozimvendimi për formimin e grupit punues për hartimin e Planit të punës së Kuvendit për vitin 2018 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

**Pika e katërbëdhjetë  
Të ndryshme**

**Halim Halimi** tha se për këtë pikë të rendit të ditës të gjithë kanë për të folur, e që ka të bëjë me kompensimin e vogël që e marrin anëtarët e Kuvendit, e që përmendet edhe kompensimi prej 90 € për mbledhje solemne. Prandaj propozoj që mbledhjet të paguhen me rregull, çoftë ato solemne apo të jashtëzakonshme.

**Osman Billaca** tha se pika e cila u propozua që të futet në rend të ditës, e që e lamë për fund, është "Plani i veprimit për persona me aftësi të kufizuar në komunën e Prishtinës 2018 - 2020", andaj propozoj që të dërgohet për shqyrtim në Kuvend.

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua propozimi që Plani i veprimit për persona me aftësi të kufizuar në komunën e Prishtinës 2018 - 2020, të jetë pikë e rendit të ditës, e kjo pikë të dërgohet për diskutim në mbledhjen e Kuvendit.**

**Mbledhja përfundoi në orën 12:00.**

**Procesmbajtësja  
Lindita Spahia**

**Kryesuesi i Komitetit  
Agim Kuleta**

